



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës

---

VENDIM

Nr. 219 , datë 16 . 03 . 2012

**“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16 . 03 .2012, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimi i raportit të hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

**Baza ligjore:** Neni 4, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Udhëzuesi mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta publike”, si dhe nenet 12 dhe 12/1 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

### **VËREN SE:**

Në bazë të një ankese nga një ndërmarrje dhe pas monitormit të tregut, Komisioni i Konkurrencës me vendimin Nr. 211, datë 23.12.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Në zbatim të këtij vendimi, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka realizuar procedurat e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”.

Sipas evidencave të administruara gjatë inspektimeve të befasishme rezultoi se në dokumentat e këtyre ndërmarrjeve të paraqitura në procedurat e tenderave publike ka shenja të bashkëpunimit (*gabime drejtshkrimore; formular të leshuar në të njejtën datë dhe numra serialë të njepasnjeshëm nga kompani sigurimi të njëjta; të njëjtën formulim, formatim në ofertën ekonomike etj*) të cilat tregojnë që përgatitja e ofertave për pjesëmarrjen në prokurimet publike është bërë nga një numër punonjësish të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetërin.

Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezultoi se ekzistojnë evidenca, në formë elektronike dhe shkresore, të bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Sajmiri AL”, “NAZERI – 2000”, dhe “Dea Security” për pjesëmarrjen në prokurimet publike, çka mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve që veprojnë në tregun përkatës në kuptim të nenit 4 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Konkluzionet e hetimit paraprak tregojnë për një bashkëpunim të mundshëm në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe të sigurisë fizike ndërmjet ndërmarrjeve “Eurogjici Security”, “Toni Security”, Eurogjici Security 1”, “Sajmiri AL”, “Nazeri – 2000”, dhe “Dea Security” sjellje të cilat mund të bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12

dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

### **V E N D O S I:**

I. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” Sh.p.k”, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore 2009 - 2011.

III. Përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar si vijon:

- a) Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
- b) Inspektime në ndërmarrjet nën hetim, nëse del e nevojshme gjatë hetimit;
- c) Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
- d) Hartimi i raportit përfundimtar të hetimit të thelluar brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

<b>KOMISIONI I KONKURRENCËS</b>		
<b>Servete GRUDA</b>	<b>Koço BROKA</b>	<b>Rezana KONOMI</b>
(_____)	(_____)	(_____)
<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
		<b>Lindita MILO (LATI)</b>
		_____
		<b>KRYETAR</b>